

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

MINISTRIA E DREJTËSISË

BYROJA PËR VLERËSIM



PLANI STRATEGJIK I BYROSË PËR VLERËSIM

2026-2028

Gusht, 2025



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА ПРАВДА/MINISTRIA E DREJTËSISË
БИРО ЗА ПРОЦЕНА - BYROJA PËR VLERËSIM

Бр./Nr. 05-99/9
25.09 2025 год./viti
СКОПЈЕ - SHKUP

Shkup

1.1	HYRJE.....	3
1.2	ANALIZA E GJENDJES.....	3
1.3	MISIONI I BYROSË PËR VLERËSIM (BV) ¹	5
1.4	VIZIONI I BV-së.....	5
1.5	DETYRA DHE OBLIGIME TË BV- së.....	5
1.5.1	PARIME THEMELORE NË PUNËN E BV-së.....	6
1.6	SPECIFIKA E BV-së	7
1.7	STRUKTURA E BV-së.....	7
1.8	PRIORITETE DHE QËLLIME TË BV-së.....	9
1.9	SHQYRTIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA TË BV-së NË VITIN 2024.....	10
1.10	SHQYRTIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA DHE TË PRITSHME TË BV- së GJATË GJYSMËS SË PARË TË VITIT 2025.....	11
1.11	PROGRAME.....	13
2.	PLANI I REALIZIMIT TË STRATEGJISË PËR PERIUDHËN 2026-2028 (PROGRAMI DHE NËNPROGRAMI).....	13
3.	NDIKIME MBI BURIMET NJERËZORE	21
4.	PARIMI I PËRFAQËSIMIT TË DREJTË	22
5.	PARIMI I MUNDËSIVE TË BARABARTA TË GRAVE DHE BURRAVE	23

¹ Byroja për Vlerësim – në tekstin e mëtejshëm do të përdoret akronimi BV

6. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE TË PËRBASHKËTA TË BV-së.....	24
7. SHTOJCA 1: FORMULARI I PËRCAKTIMIT TË RREZIQEVE	27

1.1. HYRJE

Plani Strategjik i BV-së për periudhën 2026-2028 është një dokument i shkruar, i cili liston karakteristikat kryesore të BV-së, siç janë: misioni, vizioni, detyrat dhe përgjegjësitë e BV-së, specifikat, struktura organizative e BV-së, qëllimet strategjike dhe prioritetet e BV-së. Në pjesën e matricës është përcaktuar programi, nënprogramet dhe aktivitetet e BV-së dhe burimet e nevojshme dhe burimet financiare për zbatimin e tyre. Gjithashtu është kryer shqyrtimi i rezultateve të arritura në vitin 2024 dhe rezultateve të pritura në vitin 2025. Planifikimi strategjik si tërësi përzgjedhjeje aktivitetesh është proces i organizuar i ndryshimeve kolektive, të cilat përfshijnë qëllimet, burimet, kriteret e përzgjedhjes, strukturat që përbëjnë qëllimin e këtij procesi. Plani Strategjik si instrument bazë pasqyron prioritetet, synimet dhe detyrat e BV-së, të koordinuara me objektivat prioritare të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat janë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për një periudhë tre vjeçare.

Plani Strategjik i BV-së (2026-2028) përfaqëson vazhdimësi të vazhdueshme të proceseve të reformës në fushat për të cilat është kompetente BV-ja.

1.2. ANALIZA E GJENDJES

Plani strategjik i BV-së për periudhën 2026-2028 është përgatitur në bazë të bazës së të dhënave të analizuar të aplikacioneve softuerike në dispozicion të BV-së, të tilla si: numri i kërkesave të pranuar për ekspertizë dhe vlerësim, fushat e kërkuara për ekspertizë dhe vlerësim, numri i lëndëve të përfunduara, numri i lëndëve të përfunduara në kohë, lëndët e kthyera të pazgjidhura, ekspertët dhe vlerësuesit e licencuar në dispozicion, ankesat/parashtresat/gjobat për ekspertët dhe vlerësuesit, etj.

Për shqyrtimin realist, objektiv dhe gjithëpërfshirës të pozicionit të BV-së në tërësi, u përdor mjeti i njohur SWOT, siç tregohet në tabelën më poshtë:

PËRPARËSI (PIKAT E FORTA) - stafi profesional dhe administrativ në dispozicion për të kryer punë në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizës; - përkushtimi i punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për përfundimin cilësor dhe në kohë të detyrave dhe obligimeve të punës; - baza e fortë informatike dhe softuerike për përgatitjen e vlerësimeve dhe ekspertizave me cilësi të lartë dhe të sakta; - sistemi i krijuar funksional për përgatitjen e vlerësimeve.	DOBËSI (PIKAT E DOBËTA) - mungesa e burimeve njerëzore në sektorë të caktuar; - motivimi i pamjaftueshëm financiar i stafit profesional të licencuar për të kryer punë në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizës; - shfrytëzimi i pamjaftueshëm i BV-së për nevojat e organeve shtetërore.
MUNDËSI - forcimi i rolit të BV-së si organi i vetëm i administratës shtetërore që kryen punë profesionale në fushën e vlerësimit; - plotësimi i stafit me ekspertë për kryerjen e vlerësimeve në fusha të ndryshme; - përmirësimi i njohurive dhe zhvillimi profesional në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare të vlerësimit.	KËRCËNIME (RREZIQE) - kuptim i pamjaftueshëm i rolit të BV-së; - rritja e largimeve të burimeve njerëzore nga BV-ja; - numër i pamjaftueshëm i bashkëpunëtorëve të jashtëm të angazhuar nga BV-ja si ekspertë nga fusha të ndryshme; - pamundësia për t'iu përgjigjur në kohën e duhur numrit në rritje të kërkesave për vlerësim bazuar në stafin aktual në dispozicion.

1.3. MISIONI I BV-së

BV-ja, si organ i administratës shtetërore, ka detyrën parësore t'u përgjigjet kërkesave për vlerësim dhe ekspertizë në mënyrë cilësore, profesionale dhe në kohë.

1.4. VIZIONI

Cilësi dhe ekspertizë e lartë në shërbimet e ofruara dhe krijimi i sistemit efikas, profesional dhe objektiv në fushën e vlerësimit dhe ekspertizës.

1.5. DETYRA DHE OBLIGIME TË BV-së

BV-ja është organ administrativ shtetëror në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e personit juridik. BV-ja kryen punë profesionale në fushën e vlerësimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vlerësimin, duke zbatuar metodologjitë e përcaktuara në legjislacionin vendas dhe në përputhje me Standardet evropiane dhe ndërkombëtare të vlerësimit. Procedurat e ekspertizës të filluara deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Vlerësim (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 154 datë 20.07.2023) do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ekspertizë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 115/10, 12/14, 43/14, 104/15, 148/15, 192/15 dhe 64/18), nga ana e BV-së.

Fushat më të zakonshme për të cilat kryhet ekspertiza nga ana e BV-së janë: ekonomike dhe materiale-financiare, inxhinieri (ndërtimore-arkitektonike, komunikacioni, mekanike, elektroteknike), agronomike, gjeodezike, bujqësore, veterinare dhe ushqimore, mjekësore, IT dhe fusha të tjera.

Vlerësimet më të zakonshme që kryen BV-ja janë vlerësimet e: vlerës së ndërmarrjeve dhe kapitalit (kryegjëja themelore) të shoqërive tregtare, prona e luajtshme (automjete, makineri dhe pajisje), prona e paluajtshme (industriale, objekte ndërtimore, tokë bujqësore, pyje), etj. Disa nga këto vlerësime përdoren në proceset dhe procedurat gjyqësore të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa pjesa tjetër zakonisht ka të bëjë me: ndërtimin e segmenteve të reja rrugore dhe rehabilitimin e një pjese të atyre ekzistuese, përfundimin e segmenteve rrugore dhe hekurudhore, shpronësimin e tokës shtetërore, vlerësimin e vlerës së pronës së kapaciteteve të mëdha industriale për shitje dhe dhënie me qira, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, etj.

1.3. MISIONI I BV-së

BV-ja, si organ i administratës shtetërore, ka detyrën parësore t'u përgjigjet kërkesave për vlerësim dhe ekspertizë në mënyrë cilësore, profesionale dhe në kohë.

1.4. VIZIONI

Cilësi dhe ekspertizë e lartë në shërbimet e ofruara dhe krijimi i sistemit efikas, profesional dhe objektiv në fushën e vlerësimit dhe ekspertizës.

1.5. DETYRA DHE OBLIGIME TË BV-së

BV-ja është organ administrativ shtetëror në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e personit juridik. BV-ja kryen punë profesionale në fushën e vlerësimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vlerësimin, duke zbatuar metodologjitë e përcaktuara në legjislacionin vendas dhe në përputhje me Standardet evropiane dhe ndërkombëtare të vlerësimit. Procedurat e ekspertizës të filluara deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Vlerësim (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 154 datë 20.07.2023) do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ekspertizë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 115/10, 12/14, 43/14, 104/15, 148/15, 192/15 dhe 64/18), nga ana e BV-së.

Fushat më të zakonshme për të cilat kryhet ekspertiza nga ana e BV-së janë: ekonomike dhe materiale-financiare, inxhinieri (ndërtimore-arkitektonike, komunikacioni, mekanike, elektroteknike), agronomike, gjeodezike, bujqësore, veterinare dhe ushqimore, mjekësore, IT dhe fusha të tjera.

Vlerësimet më të zakonshme që kryen BV-ja janë vlerësimet e: vlerës së ndërmarrjeve dhe kapitalit (kryegjëja themelore) të shoqërive tregtare, prona e luajtshme (automjete, makineri dhe pajisje), prona e paluajtshme (industriale, objekte ndërtimore, tokë bujqësore, pyje), etj. Disa nga këto vlerësime përdoren në proceset dhe procedurat gjyqësore të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa pjesa tjetër zakonisht ka të bëjë me: ndërtimin e segmenteve të reja rrugore dhe rehabilitimin e një pjese të atyre ekzistuese, përfundimin e segmenteve rrugore dhe hekurudhore, shpronësimin e tokës shtetërore, vlerësimin e vlerës së pronës së kapaciteteve të mëdha industriale për shitje dhe dhënie me qira, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, etj.

1.5.1. PARIME THEMEORE NË PUNËN E BV-së

- Profesionalizëm

Synimi për të monitoruar vazhdimisht inovacionet në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizës, duke aplikuar teknikat dhe mjetet më të fundit dhe më të përparuara, me përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të aftësive dhe shkathtësive që duhet të posedojnë ekspertët;

- Objektivitet

Synimi që ekspertët të jenë objektivë në përgatitjen e detyrave të dhëna, të ndershëm dhe të lirë nga konfliktet e interesit, dhe dhënia e mendimeve të bazuara vetëm në prova që janë siguruar dhe formuar në përputhje me standardet ndërkombëtare;

- Kompetencë

Synimi për të poseduar njohuri, përvojë, objektivitet dhe autoritet gjatë përgatitjes së vlerësimit, gjetjes dhe mendimit që duhet të jetë i pavarur, real dhe në përputhje me arritjet më të larta shkencore;

- Punë ekipore

Synimi për praktikë të vazhdueshme të bashkëpunimit kolegjal, gjithëpërfshirës, konstruktiv dhe krijues të ekspertëve me respekt të vazhdueshëm për individin, duke forcuar ndjenjën e përgjegjësisë, ndërgjegjes dhe profesionalizmit, të cilat janë kusht për arritjen e misionit, vizionit dhe qëllimeve strategjike të BV-së;

- Transparencë

Synimi për të siguruar vazhdimisht transparencë në punë;

- Integritet

Për të ruajtur besimin në ekspertizë dhe profesionalizëm në përgatitjen e vlerësimeve, gjetjeve dhe mendimeve, sjellja e ekspertëve duhet të jetë jashtë çdo dyshimi dhe qortimi. Integriteti kërkon që ekspertët t'i kushtojnë vëmendje si formës dhe qëllimit të BV-së, ashtu edhe standardeve etike, me qëllim përmbushjen e nevojave të sektorit publik dhe privat në RMV.

1.6. SPECIFIKA E BV-së

BV-ja është organi i vetëm i administratës shtetërore që kryen punë në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizës. Për më shumë se katër dekada, BV-ja ka qenë segment i rëndësishëm në sistemin gjyqësor të vendit, duke kryer punë profesionale në fushën e ekspertizës dhe super-ekspertizës për nevojat e gjykatave dhe prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për nevojat e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike, shoqërive tregtare të themeluara nga shteti, personave fizikë dhe juridikë, si dhe për subjekte të tjera për të cilat kërkohet të kryhet ekspertiza.

Me ndryshimet në Ligjin për Ekspertizë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 154 datë 20.07.2023), Byroja për Ekspertiza Gjyqësore vazhdon të funksionojë si Byro për Vlerësim.

1.7. STRUKTURA E BV-së

2. BV-ja, në përputhje me Rregulloren e organizimit të brendshëm nr. 01-30/1 datë 17.01.2024 dhe Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës nr. 01-30/2 datë 17.01.2024, është organizuar në:

➤ Tre sektorë me 6 seksione gjithsej:

1. Sektori për ekspertizë dhe vlerësime ekonomike me dy seksione.
2. Sektori për ekspertizë dhe vlerësime inxhinierike me dy seksione.
3. Sektori për çështje ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta me dy seksione.

➤ dhe dy seksione të pavarura:

1. Seksioni i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe
2. Seksioni i çështjeve financiare.

BYROJA PËR VLERËSIM - Shkup

DREJTOR

SEKSIONI
për menaxhim të
burimeve njerëzore

SEKSIONI
për çështje financiare

SEKTORI
për ekspertiza dhe
vlerësime ekonomike

SEKTORI
për ekspertiza dhe
vlerësime inxhinierie

SEKTORI për
çështje ligjore, të përgjithshme
dhe të përbashkëta

SEKSIONI
për ekspertiza dhe
vlerësime materiale
dhe kontabël në fushën
e shoqërive tregtare,
ndërmarrjeve publike
dhe personave të tjerë
juridike, pronësish
industriale
dhe mjeteve të
transportit

SEKSIONI
për
ekspertiza dhe
vlerësime
financiare në fushën e
pasurive të luajtshme
dhe të pretendimeve
dhe detyrimeve

SEKSIONI
për ekspertiza dhe
vlerësime ndërtimore-
arkitektonike
bujqësore në fushën e
pasurive të paluajtshme
dhe bujqësisë, pylltarisë
dhe ekonomisë
se ujërave

SEKSIONI
për ekspertiza dhe
vlerësime e elektroteknike
dhe mekanike në fushën
e makinerive
dhe pajisjeve,
mjeteve të transportit
dhe
pajisjeve informatike

SEKSIONI
për çështje ligjore
dhe të përgjithshme

SEKSIONI
për koordinim
(mbështetje) të
aktiviteteve
të drejtorit

2.6. PËRPARËSI DHE QËLLIME TË BV-së

Prioriteti strategjik i BV-së:

- Vlerësime dhe ekspertiza me cilësi të lartë, profesionale dhe të përgatitura në kohë.

Qëllimet strategjike të BV-së:

- Përmirësimi i cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e vlerësimeve dhe ekspertizave dhe
- Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit në punën e institucionit.

Qëllimet strategjike të BV-së që lidhen me Ministrinë e Drejtësisë:

Sundimi i ligjit nëpërmjet zbatimit të plotë të ligjeve

Gjatë përcaktimit të prioritetëve dhe qëllimeve të saj strategjike, BV-ja para së gjithash kishte parasysh prioritetet strategjike të identifikuara të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Vendimin për përcaktimin e prioritetëve strategjike për vitin 2025.

1.9. SHQYRTIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA TË BV-së NË VITIN 2024

Për sa i përket rezultateve të arritura të BV-së për vitin 2024, veçojmë:

- U pranuan gjithsej 588 lëndë (ekspertiza, ekspertiza shtesë, super-ekspertiza dhe vlerësime) dhe u përfunduan 642 lëndë (aktuale dhe nga stoku i viteve të kaluara).
- Ekspertiza dhe super-ekspertiza të përgatitura profesionalisht, ku janë pranuar gjithsej 230 dhe përfunduar 419 lëndë, ndërmjet të cilave ka lëndë komplekse në fushën e krimit të organizuar, lëndë për aksidente rrugore me pasoja të rënda, lëndë në procedura penale dhe civile me ekspertiza të gjera ndërtimore, financiare dhe materiale dhe ekspertiza në fusha të tjera specifike.
- Vlerësime të kryera me cilësi, ku janë pranuar gjithsej 358 dhe përfunduar 223 lëndë, dhe në kornizat e një lënde ka vlerësime të shumta. Zakonisht kërkues më të shpeshtë të vlerësimeve të tilla janë institucionet e mëposhtme:
 - Ministritë,
 - Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik,
 - NP për Rrugët Shtetërore,
 - Burimet Kombëtare të Energjisë,
 - Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Sekuestruar,
 - SH.A. për Ndërtimin dhe Menaxhimin e Hapësirave Banesore dhe Tregtare me Rëndësi Kombëtare,
 - Drejtoria e Ekonomisë së Ujërave
 - Institucione publike shëndetësore etj.

Vlerësimet më të rëndësishme që janë realizuar në vitin 2024 janë vlerësimet e mëposhtme:

- Vlerësime në lidhje me procedurën e shpronësimit për ndërtimin e segmentit autostradës A2 Kërçovë-Ohër,
- Vlerësimi i makinerive dhe pajisjeve të konsumuara,
- Vlerësimi i sendeve të luajtshme,
- Vlerësimi i pronës së paluajtshme,

- Vlerësimi i pronës dhe pajisjeve të konfiskuara etj.
- Pjesë e ekipit të shpronësimit të udhëhequr nga Ministria e Financave, për ndërtimin e Korridorit 8 dhe Korridorit 10 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Edukim i vazhdueshëm profesional që synon përmirësimin e profesionalizmit të ekspertëve dhe vlerësuesve në përgatitjen e ekspertizave dhe vlerësimeve.

Tregues i suksesit: Numri i lëndëve të përfunduara.

1.10. SHQYRTIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA DHE TË PRITSHME TË BV-së NË GJYSMËN E PARË TË VITIT 2025

- Deri në muajin korrik të vitit 2025, u pranuan gjithsej 413 lëndë (ekspertiza, ekspertiza shtesë, super-ekspertiza dhe vlerësime) dhe u përfunduan 294 raste.
- Ekspertiza dhe super-ekspertiza të përgatitura profesionalisht, me 72 lëndë të përfunduara, duke përfshirë raste komplekse në fushën e krimit të organizuar, lëndë të aksidenteve rrugore me pasoja të rënda, lëndë në procedurë penale dhe civile me ekspertiza të gjera ndërtimore, financiare dhe materiale dhe ekspertiza nga fusha të tjera specifike.
- Vlerësime të përgatitura profesionalisht, ku janë pranuar gjithsej 351 dhe janë përfunduar 222 lëndë, ku brenda një lënde ka vlerësime të shumta. Zakonisht kërkues më të shpeshtë të vlerësimeve të tilla janë institucionet e mëposhtme:
 - Ministritë,
 - NP për Rrugët Shtetërore,
 - NP për Infrastrukturën e Hekurudhave Hekurudhat Maqedonase,
 - Agjencia për Menaxhimin me Pronën e Sekuestruar,
 - SHA për Ndërtimin dhe Menaxhimin e Hapësirave Banesore dhe Tregtare me Rëndësi Kombëtare,
 - Institucione publike shëndetësore etj.

Vlerësimet më të rëndësishme që janë realizuar në gjysmën e parë të vitit 2025 janë vlerësimet e mëposhtme::

- Vlerësimet që lidhen me projektin e Korridorit 8 (segmenti Tetovë – Gostivar – Bukojçan dhe projekti i autostradës Trebenishtë – Strugë – Qafë-Thanë) dhe projekti i Korridorit 10D (segmenti i autostradës Prilep – Manastir),
 - Vlerësimi i makinerive dhe pajisjeve të konsumuara,
 - Vlerësimi i sendeve të luajtshme,
 - Vlerësimi i pronës së paluajtshme,
 - Vlerësimi i pronës dhe pajisjeve të konfiskuara etj.
- Byroja është pjesë e ekipit të shpronësimit të udhëhequr nga Ministria e Financave, për ndërtimin e Korridorit 8 dhe Korridorit 10 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
 - Edukimi i vazhdueshëm profesional me qëllim përmirësimin e profesionalizmit të ekspertëve dhe vlerësuesve në përgatitjen e ekspertizave dhe vlerësimeve.

1.11 PROGRAME

Plani strategjik i BV-së për periudhën 2026-2028 përmban një program strategjik: PUNË PROFESIONALE NGA FUSHA E VLERËSIMEVE DHE EKSPERTIZAVE dhe i njëjti është zhvilluar në nivelin e tri nënprogrameve.

2. PLAN PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË SË BV-së PËR PERIUDHËN 2026-2028 PROGRAMI DHE NËNPROGAMI

2.1. PLAN PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "PUNË PROFESIONALE NGA FUSHA E VLERËSIMEVE DHE EKSPERTIZAVE"

1. PLAN PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË PËR PERIUDHËN 2026-2028 (PROGRAMI DHE NËNPROGAMI)

A: Arsyetimi i dizajnit të Programit

Arsyetim: Programi "PUNË PROFESIONALE NGA FUSHA E VLERËSIMEVE DHE EKSPERTIZAVE" rrjedh nga:

1. Prioritetet strategjike të identifikuara të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Vendimin për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2025-2029:
 - rivendosja e besimit në institucione, forcimi i sigurisë, lufta efektive kundër korrupsionit dhe krimit, pavarësia e gjyqësorit dhe sigurimi i sundimit të së drejtës dhe
 - administratë publike profesionale dhe efikase, zhvillim i ekonomisë digjitale, sektori i TIK-ut, intelijenca artificiale, inovacioni dhe ekosistemi i startup-eve.
2. Objektivat që rrjedhin në përputhje me këtë vendim dhe që zbatohen për BV-në si organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë janë:
 - eliminimi i korrupsionit dhe krimit dhe sigurimi i sundimit të ligjit dhe
 - administratë e aftë, profesionale dhe jopartiake.

2. NPAA (identifikoni saktë prioritetin e PE-së, Kreun, sektorin dhe temën e NPAA-së)

Kreu : 3.23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Pjesa : 3.23.1 Gjyqësori

3. Qëllime strategjike dhe prioritare të BV-së:

- Vlerësime dhe ekspertiza me cilësi të lartë, profesionale dhe të përgatitura në kohë.
 - Përmirësimi i cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e vlerësimeve dhe ekspertizave dhe
 - Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit në punën e institucionit.

3.1. Prioritetet dhe qëllimet strategjike të BV-së që lidhen me Ministrinë e Drejtësisë:

- Sundimi i ligjit nëpërmjet zbatimit të plotë të ligjeve

1. Titulli i Programit:

Punë profesionale në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizave

Qëllimi i Programit:

- Përmirësimi i cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e ekspertizave dhe vlerësimeve,
- Kontribut më i madh në ekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore në procedurat civile dhe penale,
- Forcimi i pavarësisë, rritja e efikasitetit dhe profesionalizmit të gjyqësorit,
- Luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit dhe zbatim efikas i ligjit.

Tregues për suksesin e Programit:

- Rritja e besimit te sektori publik dhe privat si rezultat i numrit në rritje të kërkesave të depozituara për vlerësim,
- Ekzekutim më i shpejtë i vendimeve gjyqësore në procedurat civile dhe penale si rezultat i përfundimit në kohë të lëndëve të ekspertizës,
- Ulja e korrupsionit dhe krimit nëpërmjet zgjidhjes efikase të lëndëve të krimit të organizuar,
- Funksionimi efikas i Prokurorisë Publike dhe sistemit gjyqësor (i lidhur me treguesit e suksesit të Programit të Ministrisë së Drejtësisë).

Programi është: (shënoni llojin e Programit)

horizontal

✓ vertikal

Plan për realizimin e Programit:

Nënprogrami 1:

- Forcimi i kapacitetit administrativ

Tregues i suksesit :

- Numri i vlerësimeve të përfunduara;
- Numri i gjetjeve dhe mendimeve të ekspertizës të përgatitura;
- Periudhë më e shkurtër kohore e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesës për vlerësim dhe ekspertizë

Nënprogrami 2: Edukim i vazhdueshëm profesional	Tregues i suksesit : - Përmirësimi i cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e vlerësimeve dhe ekspertizave; - Forcimi i pavarësisë dhe paanshmërisë në kryerjen e punës në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizave; - Profesionalizëm dhe besueshmëri më e madhe në përgatitjen e lëndëve; - Numër i reduktuar i kërkesave për gjetje shtesë, deklarata dhe përputhshmëri të gjetjeve dhe mendimeve të ekspertizës; - Lëndë të krimit të organizuar të zgjidhura me sukses;
Nënprogrami 3: Përmirësimi i teknologjive dhe pajisjeve të informacionit	Tregues i suksesit : -Përmirësimi i cilësisë së vlerësimeve dhe ekspertizave dhe niveli i saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, si rezultat i zbatimit të informacionit dhe arritjeve më të fundit teknologjike në fusha të caktuara; - Rritja e efikasitetit dhe profesionalizmit të përgatitjes ekspertizave dhe vlerësimeve nëpërmjet zbatimit të metodave, mjeteve dhe pajisjeve të reja; -Zvogëlimi i kohës së nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga përgatitja e ekspertizave dhe vlerësimeve dhe kontributi më i madh në ekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore në procedurat civile dhe penale; - Forcimi i pavarësisë, rritja e efikasitetit dhe profesionalizmit të gjyqësorit dhe Prokurorisë Publike; - Luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit dhe zbatim efikas i së drejtës.

B Programi 1: Plani i realizimit

Nënprogrami 1: Plani i realizimit

Aktiviteti	Përgjegjës	Të konsultuar	Korniza kohore		Burime të nevojshme	
			Fillimi (muaji/viti)	Fundi (muaji/viti)	njerëzore	financiare MKD
1. Depozitimi i kërkesës për miratimin e mjeteve për ngritje në detyrë dhe punësime të reja	BV	MF	1/2026	12/2026	Të punësuar në BV	2.275.470 (Shuma e kërkuar në programin Buxhetor 2-Ekspertiza gjyqësore)
2. Zbatimi i procedurës për ngritjet në detyrë dhe punësimet e reja	BV	AA/MA	1/2026	12/2026	Të punësuar në BV	50.000 (Shuma e kërkuar në Programin Buxhetor 2-Ekspertiza gjyqësore)
Aktivitete gjithsej në vitin 2026:2						
Aktivitete gjithsej në vitin 2027:0						
Aktivitete gjithsej në vitin 2028:0						

Gjithsej për rezultat 1: 2						2.325.470
----------------------------	--	--	--	--	--	-----------

Nënprogrami 2: Plani i realizimit

Aktiviteti	Përgjegjës	Të konsultuar	Korniza kohore		Burime të nevojshme	
			Fillimi (muaji/viti)	Fundi (muaji/viti)	njerëzore	financiare MKD
1. Pjesëmarrje e vazhdueshme në trajnime dhe seminare me qëllim monitorimin e ndryshimeve aktuale në rregullativat ligjore dhe zbatimin e së drejtës.	BV		1/2026	12/2028	Të punësuar në BV	600.000 (Shuma e kërkuar në Programin Buxhetor 2-Ekspertiza gjyqësore)
Aktivitete gjithsej në vitin 2026:1						
Aktivitete gjithsej në vitin 2027:1						
Aktivitete gjithsej në vitin 2028:1						
Gjithsej për rezultat 2: 3						600.000

Nënprogrami 3: Plani i realizimit

Aktiviteti	Përgjegjës	Të konsultuar	Korniza kohore		Burime të nevojshme	
			Fillimi (muaji/viti)	Fundi (muaji/viti)	njerëzore	financiare MKD
1. Përgatitja e planit të prokurimeve publike që do të parashikonte prokurimin e aplikacioneve softuerike dhe zgjidhjeve ideore dhe pajisjeve, si dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese.	BV	BPP	1/2026	12/2028	Të punësuar në BV	/
2. Prokurimi i aplikacioneve softuerike dhe pajisjeve të tjera që synojnë zbatimin e metodave më moderne në zgjidhjen efikase dhe përgatitjen e ekspertizave dhe vlerësimeve.	BV	MF	1/2026	12/2028	Të punësuar në BV	543.000 (Shuma e kërkuar në Programin Buxhetor 2-Ekspertiza gjyqësore)
Aktivitete gjithsej në vitin 2026:2						
Aktivitete gjithsej në vitin 2027:2						
Aktivitete gjithsej në vitin 2028:2						

Gjithsej për rezultat 3: 6						543.000
----------------------------	--	--	--	--	--	---------

3. Ndikim mbi burimet njerëzore

PROGRAMI	Rezyme e nevojës për punësime të reja	Rezyme e nevojës për risistematizimin e vendeve të punës	Rezyme e nevojës për trajnime
Punë profesionale në fushën e vlerësimeve dhe ekspertizave	Për shkak të vendeve të lira të punës, janë planifikuar 5 punësime të reja në vitin 2026.	Për shkak të motivimit më të madh të stafit profesional, janë planifikuar 2 ngritje në detyrë në vitin 2026.	- Trajnim i vazhdueshëm për ndryshimet në rregullativat ligjore në të gjitha fushat e ekspertizës dhe vlerësimit në fushën e BV-së - Trajtime në fushën e aplikacioneve softuerike - Trajtime për përdorimin e makinave, pajisjeve dhe mjeteve të reja dhe moderne në procesin e ekspertizës dhe vlerësimit

4. Parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat

2026 ndikimi i pritshëm	2027 ndikimi i pritshëm	2028 ndikimi i pritshëm
Duke u nisur nga parimi kushtetues i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, BV-ja, gjatë zbatimit të procedurave të punësimit, i kushton vëmendje parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të të gjitha komuniteteve. Në vitin 2025, parimi kushtetues i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të respektohet në procedurat e punësimit të BV-së.	Në vitin 2026, BV-ja do të vazhdojë të respektojë parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të të gjitha komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në procedurat e saj të punësimit.	Në vitin 2027, BV-ja do të vazhdojë të respektojë parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të të gjitha komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në procedurat e saj të punësimit.

5. Parimi i mundësive të barabarta të grave dhe burrave

2026 ndikimi i pritshëm	2027 ndikimi i pritshëm	2028 ndikimi i pritshëm
Arritja e barazisë gjinore do të japë kontribut kyç në përparimin drejt të gjitha objektivave të BV-së. Gratë duhet të kenë mundësi të barabarta me burrat për punësim, udhëheqje dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet. BV-ja i kushton vëmendje parimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Në vitin 2026, BV-ja do të vazhdojë të respektojë parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, gjegjësisht, ato duhet të kenë status dhe trajtim të barabartë në ushtrimin e të gjitha të drejtave.	Në vitin 2027, BV-ja do të vazhdojë të respektojë parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, gjegjësisht, ato duhet të kenë status dhe trajtim të barabartë në ushtrimin e të gjitha të drejtave.	Në vitin 2028, BV-ja do të vazhdojë të respektojë parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, gjegjësisht, ato duhet të kenë status dhe trajtim të barabartë në ushtrimin e të gjitha të drejtave.

6. Zhvillimi i funksioneve të përbashkëta

2026 masa të planifikuara	2027 masa të planifikuara	2028 masa të planifikuara
Planifikimi strategjik dhe përgatitja e Buxhetit të BV-së		
Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të BV-së, në Sektorin për çështje ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta, ekziston pozicion pune i sistematizuar, bashkëpunëtor i lartë për planifikim strategjik, dhe personi përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik është Udhëheqësi i Seksionit për koordinimin (mbështetje) e aktiviteteve të drejtorit. Në përputhje me organizimin e brendshëm të BV-së dhe procedurave të brendshme të punës, Seksioni i çështjeve financiare është përgjegjës për përgatitjen e buxhetit të BV-së. Personat përgjegjës në Seksion koordinojnë përgatitjen e buxhetit, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin strategjik, të cilat janë në funksion të arritjes së prioritetëve dhe qëllimeve strategjike të BV-së në korrelacion me politikat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.	Në vitin 2027, është planifikuar trajnim i vazhdueshëm i personit përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik dhe monitorimin e zbatimit të tij, si dhe trajnim i vazhdueshëm për personat përgjegjës në Seksionit e çështjeve financiare për përgatitjen e buxhetit. Në vitin 2027, është planifikuar të monitorohet zbatimi i Planit strategjik për vitet 2027-2029 dhe të përgatitet plan strategjik për vitet 2028-2030. Në vitin 2027, është planifikuar të përgatitet buxheti i BV-së për vitin 2028.	Në vitin 2028, është planifikuar trajnim i vazhdueshëm i personit përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik dhe monitorimin e zbatimit të tij, si dhe trajnim i vazhdueshëm për personat përgjegjës në Seksionin e çështjeve financiare për përgatitjen e buxhetit. Në vitin 2028, është planifikuar të monitorohet zbatimi i Planit strategjik për vitet 2028-2030 dhe të përgatitet plan strategjik për vitet 2029-2031. Në vitin 2028, është planifikuar të përgatitet buxheti i BV-së për vitin 2029.

Trajnimi është planifikuar për vitin 2026 për të monitoruar zbatimin e planit strategjik dhe për të përgatitur buxhetin. Në vitin 2026, është planifikuar të monitorohet zbatimi i Planit strategjik për vitet 2026-2028 dhe të përgatitet plan strategjik për vitet 2027-2029. Në vitin 2026, është planifikuar përgatitja e buxhetit të BV-së për vitin 2027.		
--	--	--

Ekzekutimi i buxhetit dhe menaxhimi i mjeteve		
Në BV, në përputhje me Rregulloren e organizimit të brendshëm, ekzekutimi i buxhetit dhe menaxhimi i mjeteve është përgjegjësi e Seksionit të çështjeve financiare, me gjashtë pozicione të sistematizuara, nga të cilat tri pozicione janë plotësuar. Pajisja e Seksionit të çështjeve financiare dhe trajnimi i punonjësve. Monitorimi i ekzekutimit të Buxhetit të vitit 2026.	Trajnim i vazhdueshëm i punonjësve në Seksionin e çështjeve financiare. Monitorimi i ekzekutimit të Buxhetit të vitit 2027.	Trajnim i vazhdueshëm i punonjësve në Seksionin e çështjeve financiare. Monitorimi i ekzekutimit të Buxhetit të vitit 2028.

Menaxhimi i burimeve njerëzore		
Në përputhje me Rregulloren e organizimit të brendshëm të BV-së, është formuar Seksioni i menaxhimit të burimeve njerëzore. Seksioni i menaxhimit të burimeve njerëzore kujdeset për zhvillimin e burimeve njerëzore në BV, duke pasur parasysh përgjegjësitë e shtuara, në përputhje me Ligjin për Nëpunësit Administrativë. Seksioni identifikon nevojat për punësim dhe merr pjesë në zbatimin e procedurave të punësimit. Identifikon nevojat për trajnim të punonjësve, mirëmban dosjet personale të punonjësve, në përputhje me detyrimin ligjor do të përgatisë Plan vjetor për përfaqësim të drejtë dhe adekuat, si dhe Program vjetor trajnimi, dhe gjithashtu do të organizojë vlerësimin e punonjësve administrativë në BV. Në vitin 2026, janë planifikuar 5 punësime të reja dhe 2 ngritje në detyrë.	Në vitin 2027, pritet të fuqizohen kapacitetet e Seksionit të menaxhimit të burimeve njerëzore. Seksioni do të vazhdojë të punojë për zbatimin e përgjegjësive të tij në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në Seksion do të vazhdojë për kryerjen efikase dhe efektive të kompetencave të Seksionit.	Në vitin 2028, Seksioni do të vazhdojë të punojë në kryerjen e përgjegjësive të tij në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në Seksioni do të vazhdojë për kryerjen efikase dhe efektive të kompetencave të Seksionit.

Çështje normative ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta		
Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të BV-së, është formuar Sektori për çështje ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta. Ky	Në vitin 2027, Sektori për çështje normative juridike, të përgjithshme dhe të përbashkëta do të vazhdojë me kompetencat për çështjet normative	Në vitin 2028, Sektori për çështje normative juridike, të përgjithshme dhe të përbashkëta do të vazhdojë me kompetencat për çështjet normative

sektor përbëhet nga dy seksione: Seksioni për çështje ligjore dhe të përgjithshme dhe Seksioni për koordinimin (mbështetjen) e aktiviteteve të drejtorit. Në vitin 2026, Sektori është kompetent për çështjet ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta të BV-së.	ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta të BV-së.	ligjore, të përgjithshme dhe të përbashkëta të BV-së.
---	--	--

7. Shtojca 1: Formulari për përcaktimin e rreziqeve

Rreziqe në nivelin e planit strategjik


Rreziku	Probabiliteti i ndodhjes së rrezikut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e qëllimeve	Masa për ballafaqimin me rrezikun
- Kuptim i pamjaftueshëm i rolit të BV-së;	mesatar	i madh	- Realizimi e takimeve me funksionarë të lartë për të prezantuar rolin e BV-së. - Miratimi i akteve nënligjore për të përcaktuar kushtet dhe mënyrën e funksionimit të BV-së.
- Rritja e largimit të burimeve njerëzore nga BV-ja;	i madh	i madh	-Miratimi i politikave për mbajtjen e stafit me masa konkrete -Nënshkrimi i marrëveshjeje kolektive të organit

Rreziqe në nivelin e programit

Rreziku	Probabiliteti i ndodhjes së rrezikut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e qëllimeve	Masa për ballafaqimin me rrezikun
- Kapacitet i pamjaftueshëm	mesatar	i madh	- Fuqizimi i stafit të Seksionit të çështjeve financiare.

administrativ për funksionimin e Seksionit të çështjeve financiare, i cili duhet t'u përgjigjet të gjitha kërkesave në fushën e operacioneve financiare;			
- Pamundësia për të zbatuar prokurimet publike në kohën e duhur dhe për të monitoruar zbatimin e tyre;	i madh	i madh	- Punësimi i një personi me licencë për kryerjen e prokurimeve publike.
- Numër i pamjaftueshëm në dispozicion i bashkëpunëtorëve të jashtëm të angazhuar nga BV-ja si staf profesional nga fusha të ndryshme;	mesatar	i madh	- Organizimi i konferencave për prezantimin e fushave me përfaqësim të dobët me vlerësues të licencuar dhe për tërheqja e stafit profesional për të marrë licencë nga fushat adekuate.
- Pamundësia për t'iu përgjigjur në kohën e duhur numrit në rritje të kërkesave për vlerësim në përputhje me stafin aktual në dispozicion.	mesatar	i madh	- Punësimi i kuadrove të reja. -Shtesë page për punonjësit me ngarkesë pune të shtuar.

Përgatiti: Gabriela Paunova



Директор/Drejtor

Fejsal Beadini

